

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti : Ndertim I linjes se furnizimit me uje per ujsjellesin Morave dhe linja ne Dushnik.

HYRJE

Projekti per objektin ” Ndertim I linjes se furnizimit me uje per ujsjellesin Morave dhe linja Dushnik” u hartua ne baze te kerkesave te komunitetit perkates qe furnizohen me uje dhe interesit ekonomik te ndermarrjes.

Projekti u konceptua duke marre parasysh kerkesat e porositesit per te realizuar nje nderhyrje sa me efikase dhe per te garantuar furnizim te qendrueshem , te sigurt dhe cilesor me uje per banoret .

Ne kete projekt do te trajtohet ndertimi i nje linje ujsjellesi Ø 125 mm nga linja kryesore Berat -Kucove (ne fshatin Lapardha 1 , lagja Qoshk) deri ne fshatin Morave (ura e Lapardhices) si dhe rikonstruksioni (zevendesimi) i nje linje prej 135 ml ne fshatin Dushnik (nga linja Ø 500mm ne drejtim te lagjes) .

Konstruimi i objektit.

Per vete natyren e objektit dhe zones ku ndodhet ai , realizimi i nderhyrjes do te realizohet duke kaluar linjen e tubacionit PE 125mm PN 10 atm dhe PE 63mm PN 10 atm , kryesisht ne toke me status shtet (rruge ,kanale etj).

Punimet e germimit .

Para fillimit te punimeve te behet planorganizimi i punimeve , ne menyre qe te percaktohen vendet e hyrje daljes ne objekt , vendet e depozitimit te materialeve, levizjet e mjeteve e makinerive , ngrehina te perkohshme .

Pasi behet piketimi i objektit , pozicionimi i tij ne terren , fiksohet aksi i kanalit .Per germim perfshihen shpenzime dhe koha per germim, hedhje dheu , mbushje, ngjeshje, largim te tepricave te dheut si dhe ndertime dhe levizje e skelave.Ne rastin tone per germim dheu me eskanator me goma eshte marre ne konsiderate dheu i kategorise se trete.Per germim dheu me makineri vleresohet vetem germimi, kurse largimi i dherave, mbushja, ngjeshja si dhe largimi i tepricave vleresohet vecas.

Punimet e betonit .

Pusetat e kontrollit do te realizohen me beton C 16/20 . Thellesia e vendosjes se tyre do te jete sipas projektit por do te vleresohen kushtet e bazamentit nga projektuesi pasi te hapen kanali.

Para betonimit do te kontrollohet nga mbikqyresi i punimeve permasat , pastrimi i kallepeve kuotat etj. Do te mbahen kubiket per te kontrolluar marken e betonit . Betoni te trajtohet me uje te pakten 7 ditet e para, te shmanget betonimi ne dite te nxehta etj. Puseta do te ndertohet prane linjes berat -Kucove , ne fshatin Lapardha 1, lagja Qoshk .Ne pusete do te vendoset lidhja me tubacioni gize Ø 300 mm , saracineska , matesi . Pusetat do te jene te mbyllura me kapak metalik

Gjate gjithe procesit te punimeve te kontrollohen zbatimi i rregullave te sigurimit teknik ne pune .

Punimet e nenshtresave .

Nenshtresat do te realizohen sipas projektit duke respektuar kuotat perkatese .

Pasi eshte hapur kanali ne thellesine dhe kuoten e kerkuar hidhet shtresa e reres nivelohet dhe mbi te vendoset tubi i ujit . behet mbushja me rere sipas projektit , dhe me pas mbushet me material te germuar me pare .

Bashkimi i tubacioneve do te behet me ngjitur sipas teknologjise perkatese me elektrofuzion.Bashkimi me rrjetin ekzistues te fshatit Morave do te behet tek ura e Lapardhices ne tubin kryesor Ø 140 mm.

Persa i perket linjes ne fshatin Dushnik , do te zevendesohet linja ekzistuese celik Ø 89mm me tub PE Ø 63 mm ,PN 10 atm ne nje distance rreth 135 ml , ku do te ndertohet nje

puse te 1*1*1.5 ne te cilen do te vendosen 15 dalje me saracineska Ø ½ " per lidhje te konsumatoreve me uje.

Tubi do kaloje brenda tubacionit ekzistues Ø 89mm deri ne vandin ku do te ndertohet puseta per shperndarje.

Tubi do te testohet para venies ne shfrytezim me nje presion 1.5 te presionit te punes normale.

Punoi

ing. Lulzim Sino

